

## DISA TË DHËNA LIDHUR ME EKSPEDITËN SHKENCORE TË VJESHTËS

Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të Tiranës, organizoi një ekspeditë shkencore gjatë muajit shtator (11-30) të vitit 1979.

Duke pasur parasysh profilet përbërëse nga njëra anë dhe interesimet e tyre nga ana tjetër, ekspedita në fjalë u organizua në dy ekiye: *ekipi i ekspeditës gjuhësore* dhe *ekipi i folklorit me etnomuzikologji*. Këto dy ekiye i përqendruan kërkimet e veta në tri treva të Kosovës: *Llap*, *Rugovë* dhe *Opojë*.

*Ekipi i ekspeditës gjuhësore* ishte i përbërë gjatë tërë qëndrimit të tij në terren prej 4 (katër) punonjesisht shkencorë; tre prej tyre ishin pandërprerje: Jorgji Gjinari (dialektolog) dhe Pavli Haxhillazi (leksikolog) nga Universiteti Shtetëror i Tiranës; Mehmet Halimi (dialektolog), bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik, ndërkaq anëtar i katërt i këtij ekipi ndërrohej sipas nevojës në terren (Menduh Begolli, Ibrahim Goçi, Ragip Mulaku, Murat Blaku e Imri Badallaj).

Ekipi i kësaj ekspedite ekploroi material dialektologjik e leksikologjik në këto fshatra të trevës së Llapit: *Pollatë*, *Bradash*, *Dumnicë e Epërme*, *Llapashticë e Poshtme*, *Lluga*, *Tërnavë* dhe *Gërdovc*.

Punonjësit shkencorë që përbënin këtë ekip, në kërkimet e tyre gjuhësore, konstatuan se e folmja e Llapit ka tipare të përbashkëta me të folmen e Gollakut dhe me atë të Shalës së Bajgorës, por ajo dallohet edhe me tiparet e saja dalluese.

Gjatë kërkimeve në terren, dialektologu, Jorgji Gjinari hetoi se në këtë të folme zanoret hundore iu kanë nënshtruar denazalizimit. Kështu për shembull dëgjohen si zanore të denazalizuarahi, *fi*, *bli*, *mulli*, *uki*, (*ulkojë*), *fli*, etj. fjalë këto që në treva të tjera shqiptohen me nazalitet të theksuar.

Në këtë të folme ashtu si edhe në të folmen e Gollakut diftongjet ruhen besnikërisht: *punue*, *shkue*, *knues*, *duek* (sh. *duej*), *dueq*, etj.

Diftongu *Ye*: *me thye*, *me kthye*, *çpërthye*, *mërthye*, *me lye*, *tlyen*. Te diftongu *ié* theksi bie më tepër në *é*: *diëlli*, *miëlli*, *e diëlle*, ndërsa *qiëlla* (qella) *n'kupë t'qëlls*, etj.

Në disa raste *i*-ja është diftonguar: *briena* (brina), ndërkaq shqiptohet *é*-ja e theksuar në fjalët: *hiéja*, *e hiëshme*, xgedha e *kiéve n't'kiém* (pjerrtas), etj.

Grupet konsonantike *mb*, *nd*, *nt*, nuk ruhen as në këtë të folme: *mas*, *përmas*, *mërthye*; *vên*, *mên*, *kuvên*, *mêt*, *qêt*, *dhêt*.

Emrat që sosin me *k*, *g*, kur shquhen marrin mbaresën *-u* për dallim nga shumë të folme që marrin *i*, si për shembull: *duek-u*, m. (sh. *duej*), *trupak-u*, *uk-u*, *dushk-u*, *binak-u*, *tfurk-u* (sh. *tfurq*), *eleniku*; *lug-ju*, *stog-u*, *shieq-u*, *zog-u* (zogu i dor's), *prag-u* (sh. *pragj*), *pllug-u*, etj.

*SH*-ja në fillim të fjalës alternohet me *ç*: *me çkrue*, *me çkri*, *me çkye*, *me çkōq*, *çpeshun*, *çpeshak*, *çpesh*, *çpejt*, *me çpue*, *me çoklue*, etj.

Ndërsa z-ja shqiptohet x: *me xgedhë, xgedha* e kiëve, *me xgidhë, me xgatë, me xbutë, xgor-i, xeher*, etj.

Sistemi foljor është mjaft i stabilizuar, aoristi përdoret në trajtë shumë të drejtë pothuaj në të gjitha foljet apofonike.

Kjo e folme shquhet për një pasuri të rrallë leksikore, veçanërisht në sferën blegtorale (në viset malore) dhe në sferën e bujqësisë e almiseve të punës, në viset rrafshinore.

Sa për dëshmi të kësaj të vërtete po veçojmë disa njësi leksikore nga gurra e pasur e leksikut të kësaj së folmeje: *katërtoj*, fol. çaj drurin në katër pjesë: *për mos m'u ça xgedha duhet me katërtue drunin*; *arsim-i*, m. krimb i bardhë blete, që nuk arrin të çelë; *grofuç-i*, m. gropë e vogël në odë të burrave a të dhomës, ku me rastin e fshirjes futen thërmiat e bukës pas ngrënies; *nerlik* ndf. *m'ka dalë ni dhâm nerlik*, stërdhëmb, dhëmb që del mbi tjetrin; *bok/ë-a*, f. lëvore kungulli, gjysma e kungullit të gërryer; *hunoç* mb. hundmadh; *bishtëtar-i*, m. punëtori që prashit përskaaj pjesës së prashitur; *renatar-i*, m. punëtori që ndan rendin gjatë prashitjes ose korrjes; *lidhtar-i*, m. punëtori, që lidh duajt gjatë korrjes; *plast-i*, m. tubë bari, një grumbull sanë; *zavall-i*, m. sana e mbledhur në zekos pas kositjes; *shieg-u*, m. qengj njëvjeçar; *shurdhë-a*, f. kapaku i lugut të mullirit, *shurdha e lugut*; *zavak-u*, m. teprica e ujit që nuk e përbin lugu e derdhet anash jazit të mullirit; *përkryedite* ndf. në të kthyer, *kesh te miku përkryedite*, u ktheva brenda ditës; *përditën* ndf. bagëtiti që nuk kthehen në drekë (në mëngez -siç i thonë vendësit); *rrotak-u*, m. organi gjenital i femrës, përdoret më tepër në rast sharjeje; *penë* ndf. model, *shko merre ni penë*; *zvenon* fol. *po zvenon uji*, burim i dobët; *shtonë-a*, f. vrimë urithi *shtonë e urit*; *kuqël-a*, f. kalliri i misrit i pashkokëluar; *djalë tënzonë*, birshpirt, fëmijë i adoptuar.

Në të folmen e Llapit fjalët *i zoti* dhe *e zoja*, që përdoren si mbiemra nuk kanë kuptim abstraktë të aftësisë, zotësisë, por kanë kuptim konkretë të zhvillimit fizik trupor, i dukshëm, i pashëm i zhvilluar: *Hasani á konë burrë i zoti*, por *jo i vyeshëm*; *grue e zoja* e madhe për nga trupi, e zhvilluar fizikisht: *Imei e kish ni nuse t'vyeshme, po hiç t'zojen, e aftë për punë, por jo e zhvilluar fizikisht*.

Në të gjitha të folmet e Kosovës ndeshim fjalë që kanë filluar të pasivizohen, që nuk përdoren në stilin bisedor të përditshëm. Me këtë dukuri u ndeshëm edhe në të folmen e Llapit. Fjalët e gjuhës letrare siç janë: *me ague, agim-i, me joshë, mëngjez-i, rërë* (ranë), *tënzonë*, etj. në të folurit e përditshëm të kësaj treve, shqipfolësit nuk i zënë ngoje si njësi të lira leksikore, por në konstrukte të shtanguara, në raste të rralla për të emërtuar dukuri konkrete i ndeshim: *u ague ferku* (agoi, zbardhi drita); *edhe burri joshet me tâ m'i prû gjânë n'mengez*; *âsht tokë rânishtë*; *ish djalë tënzonë*, në kuptim i aftë, 2 birshpirt, djalë i adoptuar, etj.

Këto relikte të këtyre fjalëve të pasivizuara dëshmojnë bindshëm se fjalët e zëna ngoje dhe shumë të tjera, dikur kanë qenë pasuri leksikore në ligjërimin e përditshëm të kësaj së folmeje. Hetimi këtyre fjalëve të pasivizuara në të folmet tona popullore na shpie te një periudhë e caktuar historike kur të gjitha të folmet shqipe kishin një fond të përbashkët leksikor, por nga shkaqet e njohura objektive një numër fjalësh thjeshtë shqipe, në disa treva të caktuara u aktivizuan, duke u bërë fond leksikor i përditshëm, ndërsa në disa treva të tjera u pasivizuan, duke u përdorur në raste shumë të rralla, madje në konstrukte të shtanguara fjalësh.

Nuk ka dyshim se këto fjalë, nga ndikimi i fuqishëm i gjuhës së sotme letrare, do të aktivizohen sërish edhe në ato treva ku deri tani konsideroheshin si leksik i pasivizuar.

Meqë kjo ekspeditë shkencore ishte e specializuar vetëm nga profilet gjuhësore, kërkimet në terren qenë më të frytshme e me rezultate më të dalluara, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër në saje të organizimit të mirë të ekspeditës dhe me ndihmën e faktorëve komunalë të Podjevës e mikpritjen e bujarinë e fshatarëve, ekspedita shkencore e vjeshtës përfundoi punën e vet në terren me sukses të plotë.